

VENDIM
Nr.125, datë 17.2.2010

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE
NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, në:

a) qarkun e Tiranës, 2 307 (dy mijë e treqind e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 709 462, 32 (shtatëqind e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy presje tridhjetë e dy) m²;

b) qarkun e Durrësit, 494 (katërqind e nëntëdhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 183 693, 96 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre presje nëntëdhjetë e gjashtë) m²;

c) qarkun e Shkodrës, 80 (tetëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 14 604, 92 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e katër presje nëntëdhjetë e dy) m²;

ç) qarkun e Lezhës, 120 (njëqind e njëzet) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 39 977, 50 (tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë presje pesëdhjetë) m²;

d) qarkun e Beratit, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 19, 89 (nëntëmbëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë) m²;

dh) qarkun e Fierit, 107 (njëqind e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 22 405, 27 (njëzet e dy mijë e katërqind e pesë presje njëzet e shtatë) m²;

e) qarkun e Dibrës, 33 (tridhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 726, 58 (nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë presje pesëdhjetë e tetë) m²;

ë) qarkun e Elbasanit, 204 (dyqind e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 34 745, 70 (tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet e pesë presje shtatëdhjetë) m²;

f) qarkun e Gjirokastrës, 28 (njëzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 304 (katër mijë e treqind e katër) m²;

g) qarkun e Vlorës, 320 (treqind e njëzet) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 113 823, 04 (njëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e tre presje katër) m²;

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha